



Universiteti i Prizrenit

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
Niveli i studimeve		<i>Bachelor</i>	<i>Programi</i>	<i>JURIDIK</i>	<i>Viti akademik</i>	<i>2016/2017</i>	
LËNDA		E DREJTA CIVILE pjesa e përgjithshme					
Viti	2	Statusi i lëndës	<i>Obligative</i>	Kodi		ECTS kredi	8
Semestri	1						
Javët mësimore		15		Orët mësimore 5		Ligjërata	<i>Ushtrime</i>
						3	2
Metodologjia e mësimit		<i>Ligjerata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste, raste studimi, detyra etj.</i>					
Konsultime		<i>Gjithmon me kërkesë të studenteve</i>					
Mësimdhënësi		<i>Prof.ass. Dr. Muharrem Faiku</i>	<i>e-mail</i>		<i>Muharem.faiku@uni-prizren.com</i>		
			<i>Tel.</i>		<i>049/147279</i>		
Asistenti		<i>Shanoela Zaçe</i>	<i>e-mail</i>				
			<i>Tel.</i>				

<i>Qëllimi studimor i lëndës</i>	<i>Përfitimet e studentit</i>
<p><i>Qëllimi I këtij moduli është që studentve të vitit të dytë të Fakultetit Juridik t'u ofroj njohuri mbi çështjet juridiko-civile ne përgjithësi . Kjo lëndë për studentët do të ofron njohuri shumë të rëndësishme mbi Aftësin-Zotësin Juridike dhe Aftësin për të Vepruar, pastaj , do mësohet për Institucionet themelore të së Drejtës Civile Pronësia, Posedimi, Servitutet, E drejta e pengut, Hipoteka Përfaqësimin, Veprimin juridik , Marrëdhëniet juridiko-civile, Klasifikimi I të Drejtës Subjektive civile , Burimet e se Drejtes Civile.</i></p>	<p><i>Pas përfundimit të këtij kursi(lënde) student do të jetë në gjendje që:1.Të përshkruaj poziten-vendin e së Drejtës Civile në sistemin e Përgjithshëm të Drejtësisë, 2.Do të jetë në gjendje të përshkruan funksionimin e marrëdhëniëve juridiko-private,</i></p> <p><i>3.Do të jetë në gjendje të bëjë krahasimin e institucioneve juridiko-civile,</i></p> <p><i>4.Do të jetë në gjendje të zhvilloje idene mbi mënyrat e krijimit ,zhvillimit dhe ndryshimit të sistemit juridik në përgjithësi.</i></p>

<i>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</i>
<p><i>E drejta civile do të mësohet permes ligjeratave, seminareve, shqyrtimi të rasteve, ushtrimeve, debateve duke mos i perjashtuar edhe format e tjera të mundëshme. Ligjeratat paraqesin metodën e prezantimit të rregullave themelore hyrëse dhe të përmbajtjes së lëndës e drejta civile.Seminaret, do të jenë një proces interaktiv i mësimit për studentë, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga</i></p>

ana e studentit nën mbikqyrjen e mësimit të lëndës. Shqyrtimi i rasteve, gjatë mësimit do të jetë pjesë e të mësuarit, përmes të cilave studentët do të kenë mundësi studimin në mënyrë analitike, të problemeve nga fusha e së drejtës civile, duke përfshirë edhe studimin e vendimeve gjyqësore. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë, duke mos i perjashtuar edhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive. Ushtrimet, janë pjesë e mësimit nga e drejta civile, përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të së drejtës trashëgimore dhe familjare. Debatet, janë pjesë e procesit të mësimit, përmes të cilave studentët mund t'i debatojnë problemet dhe dukurit nga jeta familjare dhe trashëgimore, duke i paraqitur pikëpamjet dhe sygjerimet e tyre.

Kushtet për realizimin e temës mësimore:

Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)

Metodat e vlerësimit: Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së studentit në vlerësimin parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv.	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
<p>Një nga mënyrat e vlerësimit do të jetë :</p> <p>-Vlerësimi I pare:30 %</p> <p>-Detyrat e shtëpisë ose angazhime të tjera:15 %</p> <p>-Vijimi I rregullt :5%</p> <p>-Provimi Final:50%</p> <p>Total:100%</p>	91–100 %	Njohuri të jashtëzakonshme(10)
	81 – 90 %	SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore(9)
	71 – 80 %	SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime(8)
	61 – 70 %	MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen(7)
	51 – 60 %	Mjaftushëm – mirë, por me mjaft gabime(6)
	00 - 50 %	Dështim – kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë

Obligimet e studentit:

Ligjerata 45 ore

Ushtrime 30 ore

Studenti është i obliguar të marrë pjesë rregullisht në ligjerata, pra, ligjeratat janë obligative për studentët e rregullt, ndërsa për studentët jo të rregullt nuk janë obligative. Po ashtu studentët janë të obliguar që të marrin pjesë në ushtrimet që janë vazhdimësi e ligjeratave apo jetësim i tyre në praktikë.

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjerata			
Ushtrime			
Punë praktike			
Kontakte me mësuesin/konsultime			
Ushtrime në terren			

<i>Kolokviume,seminare</i>			
<i>Detyra të shtëpisë</i>			
<i>Koha e studimit vetanak</i>			
<i>Përgaditja përfundimtare për provim</i>			
<i>Koha e kaluar në vlerësim(teste,kuize,provim final)</i>			
<i>Projekte,prezentime..etj</i>			
<i>Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 8 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 240 orë</i>		Ngarkesa totale:	

<i>Java</i>	<i>Ligjërata</i>	<i>Ushtrime</i>
<i>1</i>	<p><i>-Nocioni dhe Emërtimin i se Drejtës Civil.</i></p> <p><i>-Objekti dhe Parimet e se drejtës civile.</i></p> <p><i>- Parimet e të Drejtës sendore.</i></p> <p><i>-Parimet e të drejtës detyrimore.</i></p> <p><i>-parimet e të drejtës trashëgimore.</i></p>	<p><i>-Ushtrimet praktike lidhur me ndarjen e të drejtës (publike dhe private, karakteristikat e çdo ndarje.</i></p> <p><i>-Vendi që zë e drejta civile në sistemin e së drejtës.</i></p> <p><i>-ushtrime praktike në lidhje me parimet kryesore të drejtës civile (pjesa e përgjithshme), parimet e të drejtës sendore, parimet e të drejtës trashëgimore.</i></p>
<i>2.</i>	<p><i>-Sistemet e të drejtës civile dhe institucionet themelore të së drejtës civile.</i></p> <p><i>-Zhvillim historik i së drejtës civile. E Drejta civile dhe kodifikimet më të rëndësishme në botë.</i></p> <p><i>-Marrëdhëniet e të drejtës civile me degët tjera të së drejtës.</i></p>	<p><i>-Ushtrime në aspektin krahasimor midis kodifikimeve të ndryshme të së drejtës civile.</i></p> <p><i>-bashkëbisedim në lidhje me marrëdhëniet të cilat krijohen midis të drejtës civile nga njëra ane dhe të drejtës familjare, administrative, të punës, tregtare dhe të drejtës ndërkombëtare private nga ana tjetër.</i></p>
<i>3</i>	<p><i>-Normat juridike (kuptimi).</i></p> <p><i>-Ndarja e normave juridike, në norma ndaluese, obliguese, autorizuese, imperative, dispozitave(ndarja midis normave të vërteta dispozitave dhe plotësuese), llojet e tjera të normave.</i></p>	<p><i>-Diskutim në lidhje me kuptimin e normave .</i></p> <p><i>-ushtrime praktike në lidhje me llojet e ndryshme të normave, aspektet krahasuese midis tyre.</i></p>

4	<p><i>- Interpretimi dhe llojet e interpretimit të normave juridike (kuptimi i interpretimit të normave, teoritë e ndryshme në lidhje me interpretimin e normave).</i></p> <p><i>- Llojet e interpretimit.</i></p> <p><i>-Llojet e interpretimit sipas subjektit që bënë interpretimin e normës (interpretim ligjor, gjuhësor dhe doktrinar).</i></p> <p><i>-Llojet e interpretimit sipas metodës dhe teknikës që përdoret për interpretimin e normës juridike (interpretimi gramatikor, logjik, historik, sistematik, qëllimor, i zgjeruar dhe i ngushtuar).</i></p> <p><i>-Analogjia dhe llojet e analogjisë, kuptimi i analogjisë, llojet kryesore (ligjore dhe juridike).</i></p>		<p><i>-Diskutim në lidhje me atë se çka kuptojmë me interpretim.</i></p> <p><i>- Ushtrime praktike në lidhje me llojet e ndryshme të interpretimit.</i></p> <p><i>- Ushtrime praktike në lidhje me analogjinë dhe llojet kryesore të saj.</i></p>	
5	<p><i>-Burimet e të drejtës civile.</i></p> <p><i>-Burimet e të drejtës civile në të drejtën bashkëkohore.</i></p> <p><i>-Burimet e të drejtës civile në Kosovë gjatë sundimit osman (burimet e pashkruara, e drejta zakonore dhe e shariatit).</i></p> <p><i>-Burimet e të drejtës civile në Kosovë nga periudha 1912-1990.</i></p> <p><i>-Burimet e të drejtës civile në Kosovë pas vitit 1990.</i></p> <p><i>-Burimet pozitive subsidiare të së</i></p>		<p><i>-Diskutime në lidhje me atë se çka do të kuptojmë me burim të së drejtës, si i ndajmë burimet e së drejtës.</i></p> <p><i>-Aspektet krahasuese të burimeve të së drejtës në periudha të ndryshme.</i></p>	

	<i>drejtës civile në Kosovë.</i>		
6.	<p><i>- Marrëdhënia juridiko-civile</i></p> <p><i>-E drejta civile në kuptim objektiv dhe subjektiv.</i></p> <p><i>-Fuqia juridike, gjendja juridike, pozita juridike.</i></p> <p><i>-Subjektet e së drejtës (përgjithësisht mbi subjektet e së drejtës, zotësisë juridike, zotësisë për të vepruar dhe zotësisë deliktore).</i></p> <p><i>-Personat fizikë (aftësia juridike e personit fizikë, vdekja si fakt juridik, shpallja e personit të zhdukur për të vdekur, si fakt juridik për pushimin e zotësisë juridike, procedurat dhe pasojat e shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur).</i></p> <p><i>-Aftësia për të vepruar e personit fizik(aftësia e plotë për të vepruar, aftësia e kufizuar dhe mungesa e aftësisë së plotë për të vepruar).</i></p> <p><i>-Aftësia deliktore e personit fizik.</i></p> <p><i>-Atributet e personit fizik(emri, vendbanimi, vendqëndrimi, shtetësia).</i></p> <p><i>-Regjistrat themeltar të gjendjes civile (regjistri i të lindurve, i të martuarve, i të vdekurve).</i></p>		<p><i>-Ushtrime praktike në lidhje me subjektet e së drejtës.</i></p> <p><i>- Ushtrime në lidhje me personin fizik dhe aftësinë e tij për të vepruar, aftësinë juridike, aftësia deliktore.</i></p> <p><i>-çka kuptojmë me vendbanim, vendqëndrim she shtetësi.</i></p>
7.	<p><i>-Personat juridik (nocioni i personit juridik, llojet e tij).</i></p> <p><i>-Shoqëritë tregtare dhe shoqatat.</i></p> <p><i>-Zotësia juridike, zotësia për të vepruar dhe zotësia deliktore e</i></p>		<p><i>-Karakteristikat dalluese midis personave juridik edhe fizik.</i></p> <p><i>-ushtrime praktike për zotësinë juridik për të vepruar dhe deliktore të personit juridik.</i></p>

	<p><i>personave juridik.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Shuarja e personave juridikë.</i> - <i>Atributet e personit juridik.</i> 			
8.	<p><i>-Objekti i marrëdhënies juridike civile.</i></p> <p><i>-Sendet (nocioni i sendeve).</i></p> <p><i>-Ndarja e sendeve (në sende të luajtshme dhe të paluajtshme, në sende në qarkullim dhe jashtë qarkullimit, publike në qarkullim të kufizuar, sende të konsumueshme dhe të pakonsumueshme, sende të individualizuara dhe të përcaktuara në gjini, sende të zëvendësueshme dhe të pazëvendësueshme, sende të pjesëtueshme dhe të papjesëtueshme , të thjeshta dhe të përbëra, sende kryesore dhe aksesore, sende tubë, trupore dhe jo trupore, frutat).</i></p> <p><i>-Paraja dhe letrat me vlerë si send.</i></p> <p><i>-Të drejtat personale(e drejta e personalitetit e autorit).</i></p> <p><i>-Veprimet e njerëzve me karakter pasuror.</i></p>		<p><i>Ushtrime praktike në lidhje me sendin dhe me ndarjet kryesore të tij sipas të drejtës.</i></p>	
9.	<p><i>-Krijimi dhe shuarja e marrëdhënieve juridiko-civile.</i></p> <p><i>-Faktet juridike (nocioni), tubi i fakteve juridike, ndarja e fakteve juridike, ngjarjet natyrore, veprimet e njerëzve, veprimet e lejuara dhe të palejuara, veprimet e vullnetit.</i></p> <p><i>-Deklarimi i vullnetit, rëndësia e</i></p>		<p><i>-Ushtrime në lidhje me krijimin dhe shuarjen e marrëdhënieve juridiko-civile.</i></p> <p><i>- ushtrime praktike për faktet juridike dhe deklarimi i vullnetit.</i></p>	

	<p><i>aktit administrativ për krijimin e marrëdhënies juridike- civile.</i></p> <p><i>-Supozimet dhe fiksionet.</i></p> <p><i>-Veprimet e palejuara.</i></p>			
10.	<p><i>-Llojet e të drejtave subjektive civile</i></p> <p><i>-Të drejtat absolute(e drejta e pronësisë, e servitutit, e pengut, barra sendore, e drejta e ndërtimit.</i></p> <p><i>-Të drejtat e personaliteti.</i></p> <p><i>-E drejta e autorit (të drejtat pasurore të autorit dhe të drejtat morale, kohëzgjatja e të drejtës së autorit, natyra juridike e të drejtave të autorit.</i></p> <p><i>-Pronësia industriale (shpikja, patenta, licenca, markat tregtare dhe dizajni industrial).</i></p> <p><i>- Të drejtat relative (subjektet e marrëdhënieve detyimore, lënda e detyrimeve, dhënia, bërja, mosbërja, durimi.</i></p> <p><i>-Burimet e detyrimeve, kontrata, shkaku i dëmit, pasurimi pa bazë juridike, gjerimi i punëve të huaja pa porosi, letrat me vlerë, premtimi publik i shpërblimit.</i></p>		<p><i>-Kuptimi dhe shembuj për ndarjen midis të drejtës absolute dhe relative.</i></p> <p><i>-karakteristikat e të drejtave absolute llojet e tyre.</i></p> <p><i>-karakteristikat e të drejtave reale llojet.</i></p>	

	<p><i>-Karakteristikat e të drejtave absolute dhe relative.</i></p>			
11.	<p><i>-Pasuria (nocioni i pasurisë, pronësisë dhe posedimit, karakteristikat e pasurisë, uniteti i pasurisë, identiteti i pasurisë, trashëgimi i pasurisë)</i></p> <p><i>-Ndarja e subjekteve të së drejtës nga pasuria (vdekje, konfiskim, nacionalizim.</i></p> <p><i>-Të drejtat subjektive të bartshme(qarkullimi juridik)</i></p> <p><i>-Të drejtat subjektive të pa bartshme(të drejtat e personalitetit)</i></p> <p><i>-Përfaqësimi (personi i tretë, llojet e përfaqësimit, ligjor, kontraktues, i personit juridik, gjyqësor, prokura, forma e prokurës, vëllimi, tejkalimi, shuarja e prokurës, afarizmi tregtar).</i></p>		<p><i>-Ushtrime në lidhje me dallimet midis pronësisë dhe posedimit.</i></p> <p><i>Karakteristikat e pasurisë</i></p> <p><i>Ushtrime praktike për përfaqësimin dhe llojet e tij.</i></p>	
12.	<p><i>-Punët juridik(nocioni i punëve juridike, ndarja e punëve juridike, deklarimi i vullnetit, ndarja e punëve juridike.</i></p> <p><i>-Punët juridike formale dhe jo formale.</i></p> <p><i>-Punët juridike midis të gjallëve dhe të vdekurve.</i></p> <p><i>-Punë juridike të njëanshme dhe dyanshme.</i></p>		<p><i>-Ushtrime praktike në lidhje me punët juridike, në lidhje me ndarjen e punëve juridike kryesore, dhe modifikimin e punëve juridike).</i></p>	

	<p><i>-Testamenti.</i></p> <p><i>-Dhënia e letrave me vlerë.</i></p> <p><i>-Punët juridike kauzale dhe aleatore.</i></p> <p><i>-Punët juridike aleatore, fiduciare, të stimuluar, fiktive, punët bamirëse.</i></p> <p><i>-Modifikimi i punëve juridike.</i></p> <p><i>-Kushti (kauzal, potestativ, mix, suspensiv, rezolutiv, pozitiv, negativ.</i></p> <p><i>-Afati (i shtyeshëm, shkëputës, objektiv, subjektiv, llogaritjet e afatit, urdhëri).</i></p>			
13.	<p><i>-Pavlefshmëria e punëve juridike.</i></p> <p><i>-Pavlefshmëria absolute (shkaqet, -paaftësia për të vepruar e palëve, lënda, objekti i palejueshëm, motivi i palejueshëm, mosrespektimi i formës).</i></p> <p><i>-Punët juridike të simuluar (pavlefshmëria absolute pasojat e -</i></p> <p><i>-Pavlefshmërisë absolute, kërkitimi i nulitetit).</i></p> <p><i>- Punët juridike relativisht të pavlefshme (shkaqet e pavlefshmërisë relative, aftësia e kufizuar për të vepruar e palëve, deklarimi i vullnetit me të meta, kanosja, dhuna , lajthimi, mashtrimi).</i></p> <p><i>-Dëmtimi përtej mase.</i></p>		<p><i>-Ushtrime praktike në lidhje me pavlefshmërinë juridike të veprimtimit juridik, llojet e tij, dallimet midis tyre.</i></p>	

	<p><i>-Anulimi i punëve juridike.</i></p> <p><i>-Konvalidimi.</i></p> <p><i>-Kundërshtimi i punëve juridike (padia pauliane dhe parashkrimi i saj).</i></p> <p><i>-Parashkrimi (afatet e parashkrimit, ndalja, ndërprerja, afatet prekluzive).</i></p>			
14	<p><i>-Fitimi, ushtrimi dhe mbrojtja e të drejtave subjektive civile.</i></p> <p><i>-Fitimi derivativ i të drejtës subjektive, origjinar, bartja translative.</i></p> <p><i>-Ushtrimi i të drejtave subjektive civile, keqpërdorimi i të drejtave.</i></p> <p><i>-Padia (kuptimi edhe llojet e padive në padi sendore, personale, rivendikimit, negatore, konfesore, kondemnatore, njohje, ndryshimi.</i></p> <p><i>-Shuarja e të drejtave subjektive civile.</i></p>		<i>-Ushtrime praktike në lidhje me mbrojtjen e të drejtave subjektive.</i>	
15.	<i>Përsëritje</i>		<i>Përsëritje</i>	

LITERATURA

Literatura bazë: 1.Andrija Gams :’’Hyrye në të Drejten Civile’’, Prishtinë,1988
2. Abdulla Aliu: ‘’ E drejta Civile ‘’, Pjesa e pergjithshme, Prishtine 20013
3. Ardian Nuni :Edrejta Civile , Pjesa e pergjithshme, Tiranë 2009
4. Iset Morina, Edrejta Civile,Pjesa e pergjithshme, Prishtine 2016.

Literatura shtesë:

1. Francesco Galgano, ‘’E Drejta Private’’, Tiranë,2003
2)Perner,Spitzer, Kodek;Bürgerliches Recht, Vijenë 2012

VËREJTJE :

Vërejtje: Ndryshimet eventuale mund t'i bëjë mësime të varësisht rrethanave sa i përket orarit të ligjëratave, caktimin konsultimeve etj.

Vërejtje për studentin:

Studentet janë të detyruar të respektojnë rregullat e etikës profesionale akademike si : mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë etj.

Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas rregulloreve dhe ligjit në fuqi .

Komunikimi me student do të bëhet kryesisht përmes e-mailit dhe shpalljeve në lokalet e Universitetit